

Titulli	Aplikim per Leje per nderhyrje ne Pasuri Kulturore Materiale: Brenda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit
Përshkrimi i shkurtër i shërbimit (1-2 fjali)	Shqyrtim në Këshillin Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale i projekteve që ndodhen brënda Kufirit të Zonës Mbrojtëse të Monumentit
Kontakt	Sekretaria Teknike
Viti	2020
Tage kërkimi (të ndara me presje)	Projekt restaurimi, restaurim zona e mbrojtur monument, KKTKM
Kategoria e shërbimit	Dokumente dhe Certifikata
Ministria (zgjidhni ministrinë në varësi të së cilës është institucioni juaj)	Ministria e Kulturës
Institucioni	
Tip shërbimi	Per qytetare, biznese dhe qeveritar
Niveli i shërbimit Për info referojuni linkut	1
Përshkrimi i gjatë (i detajuar i shërbimit, i cili duhet të përfshijë edhe bazën ligjore)	Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, Neni 77 dhe V.K.M. nr. 208, datë 10.04.2019 “Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, kompetencat dhe shpërblimin e anëtarëve Të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, projektet e restaurimit, rikonstruksionit, mirëmbajtjes, konservimit apo rijetëzimit investitori brënda kufirit të zonës së mbrojtur të monumentit duhet të marrë miratimin për projektin nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale.
Dokumentacioni i nevojshëm	Dokumente shoqeruese 1. Formulari i Aplikimit Online -Të dhënat për Aplikuesin -Të dhëna për Projektuesin Restaurator (emër/mbiemër/numër licencë) - Lloji i Lejes per te cilen aplikohet -Te dhena mbi Projektin -Te dhena mbi zhvilluesin e projektit - Te dhena mbi pronesine 2. Mandat Pagesa 3. Deklarate Noteriale / Autorizim nga zhvilluesi per aplikantin (ne rastin kur aplikanti nuk eshte zhvillues i projektit 4. Lejet, licensat, autorizimet apo aktet e miratimit te nevojshme per

	ushtrimin e aktivitetit ne zbatim te legjislacionit te posacem 5. Deklarate pergjegjesie profesionale e projektuesve Dokumente nga aplikanti 1. Projektet teknike dhe relacionet perkatete, ne formatin pdf dhe i nenshkruar nga personi fizik/juridik i licensuar ne restaurim; (Plani i vendosjes së ndërtimit mbi fragmentin e azhornuar të hartës së parcelës_ave; Vendndodhja me kooordinata gjeografike; Ortofoto; Specifikime Teknike). 2. Grafiku i Punimeve 3. Preventiv 4. Prezantim Projekti ne poëerpoint 5. Projekti i plote ne format te editueshem (AutoCAD, Revit, Archicad, etj)
Hapat e procedurës	Hapat e procedurës nëse i gjithë dokumentacioni është i plotë 1. Aplikimi pranë IKTK-se (e-leje); 2. Shqyrtim nga Sekretaria Teknike për dokumentacion; 3. Shpërndarja nëpër drejtori dhe në DRTK-në ku shtrihet projekti; 4. Shqyrtimi në Këshill Teknike; 5. Shqyrtim në KKTKM dhe nxjerrja e Vendimit; 6. Shpërndarja e Vendimit.
Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit	45 ditë, në rastet e nevojshme për verifikim të natyrës teknike afati është 60 ditë
Periudha e vlefshmërisë së shërbimit (psh certifikatës së dhënë etj.)	Sipas grafikut të punimeve të depozituar
Kostot për marrjen e shërbimit	Në proces miratimi të kostove të shërbimit
Të tjera (orari i hapjes etj.)	Orari i shqyrtimit të kërkesave: E hënë – E enjte 8:00 – 16:30 E premte 8:00 – 14:000